

-35-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

---

**V E N D I M**

**Nr. 1 Date 26.07 .2011**

“PER  
MIRATIMIN E LEJES  
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE  
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9,”Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”,si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

**V E N D O S I :**

- 1- MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, Lumi Valbones , Rrethi Tropoje, per hidrocentralin ” Dragobia ”, Shoqerise “ Dragobia Energy ” sh.p.k. per prodhim hidroenergjie, nga kuota e vepres te marrjes, + 963 m ne perroin e Qeremit, + 573m ne lumin e Valbones, + 850 m ne perroin e Matines, + 1000 m ne perroin e Milloshit, deri ne kuoten + 535 m ku do ndertohert godina centralit. Sasia e ujit qe do perdore eshte  $Q= 12.29$  m<sup>3</sup>/sek. Shoqeria “ Dragobia Energy “ ka Kontrate Koncesionare me M.E.T.E.
- 2- Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

Muhamet MUÇA



**Kryetari**

**Sekretari Pergjithshem i Prefektures**

Fatbardh SHEQI